

Our Heavenly Guidance System

By Elder Sergio R. Vargas
Of the Seventy

Sistemi Ynë Qiellor i Udhërrëfimit

Nga Plaku Serhio R. Vargas,
i Të Shtatëdhjetëve

April 2025 general conference

As we focus our lives on Jesus Christ, we will find our way home, enduring to the end and rejoicing to the end.

Jesus Christ changed my life when I was baptized at the age of 26 in my beloved Frutillar, Chile. At that time, my job took me across the ocean, rivers, and lakes of the beautiful Chilean Patagonia. After my baptism, I saw my work and my life in a new and different way, recognizing that truly “all things denote there is a God.”

In nature, salmon are born in the source of the rivers. At some point in their lives, they need to swim downriver to reach the ocean, where they find the nourishment and conditions necessary for their development.

But the ocean is also a dangerous place where predators lurk and where fishers try to catch the salmon with flashy hooks that imitate food but do not nourish them. If the salmon can survive these threats, they will be ready to use their powerful guidance system to return upriver to the same place where they were born, facing new and some familiar challenges. Scientists have studied their migratory behavior for years and have discovered that they use a type of magnetic map, similar to GPS, to guide them to their final destination with incredible precision.

We can all return one day to the heavenly home from where we came. And like the salmon, we have our own magnetic map, or Light of Christ, to guide us there. Jesus taught His disciples, “I am the way, the truth, and the life: no

Kur e përqendrojmë jetën tonë te Jezu Krishti, ne do ta gjejmë udhën drejt shtëpisë, duke duruar deri në fund dhe duke u gëzuar deri në fund.

Jezu Krishti ma ndryshoi jetën kur u pagëzo-va në moshën 26-vjeçare në Frutijarin tim të dashur, në Kili. Në atë kohë, puna më çonte nëpër oqeanin, lumenjtë dhe liqenet e Patagonisë së bukur kiliane. Pas pagëzimit tim, e shihja punën dhe jetën time në një mënyrë të re dhe të ndryshme, duke e dalluar që vërtet “të gjitha gjërat tregojnë se ka një Perëndi”.

Në natyrë, salmonët lindin në burimin e lumenjve. Në njëfarë pike të jetës, atyre u nevojitet të notojnë duke zbritur në rrjedhën e lumit që të arrijnë oqeanin, ku gjejnë ushqimin dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre.

Por oqeani është edhe një vend i rrezikshëm, ku grabitqarët rrinë në pritë dhe ku peshkatarët përpiqen t’i kapin salmonët me grepa me ngjyra të ndezura që imitojnë ushqimin, por që nuk i ushqejnë ata. Nëse salmonët u mbijetojnë këtyre kërcënimeve, ata do të jenë gati për të përdorur sistemin e tyre të fuqishëm të udhërrëfimit për t’u ngjitur përpjetë lumit drejt vendit ku u lindën, duke u përballur me sfida të reja dhe disa të njohura. Shkencëtarët e kanë studiuar sjelljen e tyre shtegtuese për vite të tëra dhe kanë zbuluar se ata përdorin një lloj harte magnetike, e ngjashme me GPS-në [Sistemin Global të Pozicionimit], për t’i udhërrëfyer drejt vendmbërritjes së tyre përfundimtare me përpikëri të pabesueshme.

Ne të gjithë mund të kthehemi një ditë drejt shtëpisë qiellore nga ku erdhëm. Ashtu si salmonët, edhe ne kemi hartën tonë magnetike, ose Dritën e Krishtit, që të na udhërrëfejë për atje. Jezu si u mësoi dishepujve të Tij: “Unë jam udha, e

man cometh unto the Father, but by me.”

As we focus our lives on Jesus Christ, we will find our way home, enduring to the end and rejoicing to the end. President Russell M. Nelson taught that “the joy we feel has little to do with the circumstances of our lives and everything to do with the focus of our lives.”

Our Divine Nature and Destiny

From the family proclamation, we read that “each [of us] is a beloved spirit son or daughter of heavenly parents, and, as such, each has a divine nature and destiny. ... In the premortal realm, spirit sons and daughters knew and worshipped God as their Eternal Father and accepted His plan by which His children could obtain a physical body and gain earthly experience to progress toward perfection and ultimately realize their divine destiny as heirs of eternal life.”

Before His birth in mortality, Jesus Christ appeared to Moses and spoke to him on behalf of the Father. He told Moses He had a great work for him to do. During that meeting, the Lord called him “my son” several times.

After that experience, Satan came tempting him, saying, “Moses, son of man, worship me.”

Moses responded to the temptation by remembering his divine nature, saying, “Who art thou? For behold, I am a son of God.” The truth freed Moses from an attack by the adversary.

Brothers and sisters, the hooks of mortality are real. They are often enticing, but they seek only one target: to pull us out of the course of living waters that lead to the Father and eternal life.

I know how real the hooks of mortality can be. One Sunday, as a new convert, I was teaching a priesthood class when an unsettling conversation arose. I struggled to finish my lesson. I took offense and felt that I was the victim. Without saying a word, I headed for the exit with the idea that I would not return to church for a while.

At that very moment, a concerned priesthood holder stood in front of me. He lovingly invited me to focus on Christ and not on the situation we had experienced in class. As I looked

vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”.

Kur e përqendrojmë jetën tonë te Jezu Krishti, ne do ta gjejmë udhën drejt shtëpisë, duke duruar deri në fund dhe duke u gëzuar deri në fund. Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim se “gëzimi që ndiejmë, ka të bëjë pak me rrethanat e jetës sonë dhe ka të bëjë plotësisht me përqendrimin e jetës sonë”.

Natyra dhe Destinacioni Ynë Hyjnor

Nga proklamata për familjen lexojmë që “secili [prej nesh] është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. ... Në mbretërinë paratokësore, bijtë dhe bijat shpirtërore e njihnin dhe e adhuronin Perëndinë si Atin e tyre të Amshuar dhe e pranuan planin e Tij, me anë të të cilit fëmijët e Tij mund të merinin një trup fizik dhe të fitonin përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe përfundimisht të arrinin destinacionin e tyre hyjnor si trashëgimtarë të jetës së përjetshme.”

Përpara lindjes së Tij në vdekshmëri, Jezu Krishti iu shfaq Moisiut dhe i foli në emër të Atit. Zoti i tha Moisiut se Ai kishte një vepër të madhe që duhej bërë prej tij. Gjatë atij takimi Zoti e thirri atë “biri im” disa herë.

Pas asaj përvoje, Satani erdhi ta tundonte, duke thënë: “Moisi, biri i njeriut, adhuromë mua”.

Moisiu iu përgjigj tundimit duke sjellë ndërmend natyrën e tij hyjnore, duke thënë: “Kush je ti? Sepse, vër re, unë jam një bir i Perëndisë.” E vërteta e çliroi Moisiun nga një sulm i kundërshtarit.

Vëllezër dhe motra, grepat e vdekshmërisë janë të vërtetë. Ata janë shpesh joshës, por synojnë vetëm një objektiv: të na tërheqin jashtë kursit të ujërave të gjallë që çojnë drejt Atit dhe jetës së përjetshme.

Unë e di se sa realë mund të jenë grepat e vdekshmërisë. Një të diel, kur isha një i sapokthyer në besim, po jepja mësim në një orë të priftërisë, kur nisi një bashkëbisedim i sikletshëm. E pata të vështirë që ta mbaroja mësimin. U ndjeva i fyer dhe se isha unë viktimja. Pa thënë asnjë fjalë, u drejtova nga dalja, me idenë se nuk do të kthehesha në kishë për ca kohë.

Pikërisht në atë çast, më doli përpara një mbajtës i priftërisë i merakosur. Ai më ftoi plot dashuri që të përqendrohesha te Krishti dhe jo te gjendja që kisha përjetuar në klasë. Kur e kthej

back on the experience with him, he shared with me that he heard a voice tell him, “Go after him; he is important to me.”

My dear friends, we are all important to Him. President Nelson taught that “because of our covenant with God, He will never tire in His efforts to help us, and we will never exhaust His merciful patience with us.” Our divine nature and covenant relationship with God entitle us to receive divine help.

The Need of Nourishment

Just as salmon need to be nourished in the ocean to grow, we also need to nourish ourselves spiritually to avoid dying of spiritual malnutrition. Prayer, the scriptures, the temple, and our regular attendance at Sunday meetings are vital in our spiritual menu.

In November 1956, Ricardo García entered the waters of baptism in Chile, becoming the first member of the Church in my country. Just one day before he died, he declared before his family and friends, “Many years ago, missionaries invited me to be happy along with my family. I am a happy man. Tell everyone in Chile the gospel is happiness.”

After having been nourished with the gospel of Jesus Christ, Ricardo dedicated his entire life to serving God and his neighbor with love. His example of discipleship has blessed generations, including me. The Prophet Joseph Smith taught that “a man filled with the love of God, is not content with blessing his family alone, but ranges through the whole world, anxious to bless the whole human race.”

Return to Our Heavenly Home

Deep inside each of us is a desire to return to our heavenly home, and Jesus Christ is our heavenly guidance system. He is the way. His atoning sacrifice makes it possible for us to make sacred covenants with God. Once we make covenants, we will at times find ourselves swimming against the current. Danger, disappointment, temptation, and affliction will test our faith and spiritual strength. Ask for help. Jesus Christ understands and is always eager to share our burdens.

kujtesën te përvoja me të, ai më tregoi se kishte dëgjuar një zë t'i thoshte: “Shko tek ai; ai është i rëndësishëm për mua”.

Miqtë e mi të dashur, ne jemi të gjithë të rëndësishëm për Të. Presidenti Nelson dha mësim: “Për shkak të besëlidhjes sonë me Perëndinë, Ai nuk do të lodhet kurrë në përpjekjet e Tij për të na ndihmuar dhe ne kurrë nuk do ta shterim durimin e Tij të mëshirshëm për ne”. Natyra jonë hyjnore dhe marrëdhënia jonë besëlidhëse me Perëndinë, na japin të drejtën për të marrë ndihmë hyjnore.

Nevoja për të Ushqyerit

Ashtu si salmonët kanë nevojë të ushqehen në oqean që të rriten, edhe ne kemi nevojë ta ushqejmë veten tonë shpirtërisht për ta shman-gur vdekjen prej kequshqyerjes shpirtërore. Lutja, shkrimet e shenjta, tempulli dhe frekuentimi ynë i rregullt i mbledhjeve të së dielës janë jetike në regjimin tonë shpirtëror.

Në nëntor 1956, Rikardo Garsia hyri në ujërat e pagëzimit në Kili, duke u bërë anëtar i parë i Kishës në atdheun tim. Vetëm një ditë përpara se të vdiste, ai shpalli përpara familjes dhe miqve të vet: “Shumë vjet më parë misionarët më ftuan të jem i lumtur së bashku me familjen time. Jam një njeri i lumtur. U thoni të gjithëve në Kili se ungjilli është lumturi.”

Pasi ishte ushqyer me ungjillin e Jezu Krishtit, Rikardoja ia përkushtoi tërë jetën e vet shërbimit ndaj Perëndisë dhe të afërmeve të tij me dashuri. Shembulli i tij i dishepullimit ka bekuar breza të tërë, përfshirë mua. Profeti Jozef Smith dha mësim se “një njeri i mbushur me dashurinë e Perëndisë nuk kënaqet vetëm me bekimin e familjes së tij, por endet në të gjithë botën, i dëshiruar që të bekojë të gjithë racën njerëzore”.

Kthimi në Shtëpinë Tonë Qiellore

Thellë brenda secilit prej nesh është një dëshirë për t'u kthyer në shtëpinë tonë qiellore, dhe Jezu Krishti është sistemi ynë qiellor i udhërrëfimit. Ai është udha. Flijimi i Tij shlyes na e bën të mundur të bëjmë besëlidhje të shenjta me Perëndinë. Kur bëjmë besëlidhje, do ta shohim veten nganjëherë duke notuar kundër rrymës. Rreziku, zhgënjimi, tundimi dhe fatkeqësia do ta vënë në provë besimin dhe forcën tonë shpirtërore. Kërkoni ndihmë. Jezu Krishti e kupton dhe është gjithmonë plot zell për t'i mbajtur barrët tona bashkë me ne.

Remember that He is known as “a man of sorrows, and acquainted with grief.” The Savior taught, “In the world ye shall have tribulation: but be of good cheer; I have overcome the world.” His atoning sacrifice allows our sins to be forgiven to the point that He no longer remembers them.

We may not totally forget our sins as part of our mortal learning so we will remember not to repeat them. Instead, we will remember Him as we take the sacrament at church every Sunday. This ordinance is an essential part of worship and spiritual development. Joy comes when we understand that this is not just another day. “The sabbath was made for man” with the intention of giving us rest from the world and renewing our body and spirit.

We also remember Him when we go to the temple—the house of the Lord. Temples give us a deeper knowledge of Jesus Christ as the center of the covenant that leads us to eternal life, “the greatest of ... the gifts of God.”

Attending the temple has given me comfort and great hope about our eternal destiny. I have experienced heavenly connections with people on both sides of the veil. I’ve seen healing miracles in the lives of my young children, two of whom live with unseen illnesses that require daily care for the rest of this life.

Our family rejoices as we share about the plan of happiness. My children’s faces light up when they hear that, thanks to Jesus Christ, their “afflictions shall be but a small moment.” We love our children deeply, and we know that someday, as President Jeffrey R. Holland taught, they “will stand before us glorified and grand, breathtakingly perfect in body and mind.” Our covenants bring us closer to God to the point of making the impossible possible, filling every space of darkness and doubt with light and peace.

Thanks to Jesus Christ, there are hope and well-founded reasons to continue loving, praying, and supporting those we care about.

I know He lives. He knows us and He loves us. He is the way, the truth, and the life of the world.

I invite all of us today to center our lives on

Mbajeni në mendje se Ai njihet si një “njeri i dhembjeve, njohës i vuajtjes”. Shpëtimtari dha mësim: “Në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën”. Flijimi i Tij shlyes lejon që mëkatet tona të falen, deri në pikën që Ai nuk i kujton më ato.

Mund të mos i harrojmë tërësisht mëkatet tona si pjesë e të mësuarit në vdekshmëri, kështu që do të kujtohem që të mos i përsëritim ato. Në vend të tyre, ne do të kujtojmë Atë teksa marrim sakramentin në kishë çdo të diel. Kjo ordinancë është pjesë thelbësore e adhurimit dhe e zhvillimit shpirtëror. Gëzimi vjen kur e kuptojmë se kjo nuk është thjesht një ditë si të tjerat. [Shabati apo] “e shtuna është bërë për njeriun” me qëllim që të na japë prehje nga bota dhe të na përtëritë trupin dhe shpirtin.

Ne e kujtojmë Atë edhe kur shkojmë në tempull, në shtëpinë e Zotit. Tempujt na japin njohuri më të thellë për Jezu Krishtin si qendra e besëlidhjes që na çon drejt jetës së përjetshme, “më e madhja nga ... dhuratat e Perëndisë”.

Frekuentimi i tempullit më ka dhënë ngushëllim dhe shpresë të madhe rreth destinacionit tonë të përjetshëm. Kam përjetuar lidhje hyjnore me njerëz në të dyja anët e velit. Kam parë mrekullitë shëruese në jetën e fëmijëve të mi të vegjël, dy prej të cilëve jetojnë me sëmundje të panjohura, që kërkojnë përkujdesje të përditshme gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës.

Familja jonë ngazëllet kur flasim rreth planit të lumturisë. Fytyrat e fëmijëve të mi ndritin kur dëgjojnë se falë Jezu Krishtit, “mjerimet e [tyre] do të jenë veçse një çast i shkurtër”. Ne i duam fëmijët tanë thellësisht dhe e dimë se një ditë, sikurse dha mësim Presidenti Xhefri R. Holland, ata “do të qëndrojnë përpara nesh të përlëvduar dhe të madhërisht, të përsosur në mënyrë mahnitëse në trup dhe në mendje”. Besëlidhjet tona na sjellin më pranë Perëndisë deri në pikën sa ta bëjnë të pamundurën të mundur, duke e mbushur çdo hapësirë ku ka terr dhe dyshim, me dritë dhe paqe.

Falë Jezu Krishtit, ka shpresë dhe arsye me bazë të fortë, për të vazhduar t’i duam dhe t’i përkrahim njerëzit të cilët i kemi për zemër, dhe të lutemi për ta.

E di se Ai jeton. Ai na njeh dhe na do. Ai është drita, e vërteta dhe jeta e botës.

Bëj një ftesë që të gjithë ne sot ta përqen-

Jesus Christ and His teachings. Doing so will help us avoid biting the hooks of temptation, offense, and self-pity. We will stand as temples— holy, firm, and constant. We will weather the storms, and we will make it home, enduring to the end and rejoicing to the end. In the name of Jesus Christ, amen.

drojmë jetën tonë te Jezu Krishti dhe mësimet e Tij. Bërja e kësaj gjëje do të na ndihmojë t'i shmangim grepat e tundimit, e fyerjes dhe të keqardhjes për veten. Ne do të qëndrojmë si tempujt: të shenjtë, të palëkundshëm dhe të qëndrueshëm. Do t'u bëjmë ballë stuhive dhe do t'ia dalim të kthehemi në shtëpi, duke duruar deri në fund dhe duke u gëzuar deri në fund. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.